

**DREJTORIA ARSIMORE E FILADELFIAS**  
QENDRA MESIMORE  
440 N. BROAD STREET  
PHILADELPHIA, PENNSYLVANIA 19130  
ZYRA E SHEFIT MESIMOR  
ZYRA E KURRIKULES, MESIMIT DHE VLERESIMIT

I dashur Prind/Kujdestar:

Me anë të kësaj letre duam t'ju bëjmë me dije për një vendimin e marrë për shtyrjen e Provimeve Keystone, si një kërkesë për diplomimin e nxënësve, deri në vitin mësimor 2019-2020.

Në datën 6 Nëntor 2017, Projektligji i Parlamentit të Pensilvanisë Nr. 178 u bë Ligj. Një paragraf i këtij ligji parashikon shtyrjen e Provimeve Keystone (Algjebër, Biologji, dhe Letërsi) si një kërkesë për diplomimin, deri në vitin shkollor 2019-2020; megjithatë, Akti "The Every Student Succeeds Act (ESSA)" e ka akoma si një kërkesë që të gjithë nxënësit e shkollës së mesme të testohen një herë në Matematikë, Lexim, dhe për njohuritë e gjëra në Shkencë. Kjo do të thotë që nga nxënësit akoma kërkohet që të provohen në testin Keystone një herë.

Arsyetimi, për shtyrje të provimeve "Keystone Exams" si një kërkesë për diplomimin, sipas Departamentit të Edukimit të Pensilvanë (PDE), është si më poshtë:

- (1) Numri mjaft i lartë i nxënësve që nuk arrijnë rezultatet e duhura në një prej fushave të provimeve Keystone (Algjebër 1, Biologji, Anglisht/Artet Gjuhësore), qoftë edhe mbas riprovimeve.
- (2) Alternativat për nxënësit që nuk arrijnë rezultate pozitive në Provimet Keystone, kanë kosto të lartë dhe i kapëcejnë kapacitetet e PDE dhe të Drejtorisë Arsimore për t'i realizuar.

Në pjesën e pasme të kësaj letre ju do të gjeni Pyetjet më të Shpeshta (FAQ) – Kapitulli 4 HB 178 i Përditësuar, i cili do të sqarojë impaktin tek nxënësit. Ju lutemi shikojini me kujdes këto FAQ dhe i diskutoni me fëmijën tuaj.

Në rast se keni pyetje, ju lutemi kontaktoni [assessment@philasd.org](mailto:assessment@philasd.org). Një informacion shtesë për prindërit (i përkthyer në nëntë gjuhë) për testet PSSA dhe Keystone, mund të gjendet edhe në uebsajtin e Drejtorisë Arsimore, <https://www.philasd.org/curriculum/assessment/>.

Ju faleminderit shumë.

Sinqerisht,

Christopher Shaffer  
Zëvendës Drejtor, Zyra e Kurrikulës, Mësimit dhe Vlerësimit

## KAPITULLI 4 SB 178 I PËRDITËSUAR PYETJET MË TË SHPESHTA

### Hyrje

Me projektligjin e Senatit 178, të kthyer në ligj në datën 6 Nëntor 2017, përdorimi i Provimeve Keystone si kërkesë shtetërore për diplomim, ose si kërkesë për pjesëmarrje në Vlerësimet Bazuar në Projekt, është shtyrë deri në vitin shkollor 2019-2020. FAQ\_të më poshtë janë gjetur më të përshtatëshme për të sqaruar implikimet e HB 178.

### Impakti në nxënësit që do të diplomohen përpara viti 2020.

- 1. A është akoma si kërkesë pjesëmarrja në Provimet Keystone?**  
Kërkesat federale në lidhje me vlerësimet e shtetit nuk kanë ndryshuar. Ndërsa për nxënësit që diplomohen përpara vitit 2020, nuk janë më kërkesë që të kalojnë provimet Keystone për t'u diplomuar, pjesëmarrja në vlerësimet shtetërore mbetet një kërkesë federale.
- 2. Në rast se një nxënës që diplomohet përpara vitit 2020, nuk ka arritje në Provimin Keystone, a do të kërkohen nga ai mësimet suplementare?**  
Shkollat do të ofrojnë mësimet suplementare, por nxënësit nuk janë të detyruar t'i frekuentojnë. Caktimi i mësimëve shtesë mbetet në vlerësimin lokal të shkollës.
- 3. Në rast se një nxënës që diplomohet përpara vitit 2020 nuk ka arritje në Provimin Keystone, a do të kërkohet nga ai që të riprovohet?**  
Riprovimi nuk kërkohet; megjithatë një nxënës mund të kërkojë të ristetohet. Në rast se një nxënës ristetohet, shkolla mund t'i ofrojë ndihmë mësimore përpara riprovimit.
- 4. Në tërësi, cilat pjesë të Kapitullit 4 janë pezulluar?**  
Pjesët më poshtë evidentojnë impaktin e moratoriumit në nxënësit, që diplomohen në vitet 2018 dhe 2019:
  - a. Kërkesa shtetërore për të demonstruar arritje në Provimet Keystone, ose në Vlerësimet që Bazohen në Projekt, është pezulluar.**
  - b. Vlerësimet që Bazohen në Projekt për nxënësit që nuk kalojnë provimet Keystone edhe pas dy përpjekjeve, nuk kërkohen.**
  - c. Pjesëmarrja e nxënësve në konsultimet mësimore shtesë nuk kërkohet më tej; megjithatë, një shkollë edhe mund të ketë si opsion konsultimet mësimore.**

### Impakti në nxënësit që do të diplomohen në vitin 2020, ose më tutje.

- 1. A është kërkesë më tej pjesëmarrja në Provimet Keystone?**  
Kërkesat federale për vlerësimet e shtetit nuk kanë ndryshuar. Nxënësve që do të diplomohen në vitin 2020, ose më tutje, përsëri do t'ju kërkohet pjesëmarrja në vlerësimet shtetërore, të cilat aktualisht janë Provimet Keystone. Nxënësit i plotësojnë Provimet Keystone në kurset Algjebra 1, Biologji, Kurset Anglisht 2.
- 2. Nëse një nxënës që diplomohet në vitin 2020, ose më tutje dhe nuk ka arritur nivelin e kërkuar në Provimin Keystone, a do t'i kërkohet riprovimi?**  
Drejtoria Arsimore e Filadelfias aktualisht rekomandon ritestimin për nxënësit që diplomohen në vitin 2020 ose më tutje, të cilët e kanë përfunduar lëndën, por nuk kanë marrë vlerësimin e duhur në Provimin Keystone, në mënyrë që nxënësit të demonstrojnë aftësitë e duhura në ato lëndë. Nxënësve mund t'ju ofrohen nga shkolla mësimet të tjera shtesë, përpara ritestimit, por kjo nuk është kërkesë e detyrueshme për nxënësit që të ristetohen. Përpilimi i mësimëve shtesë është një çështje që vendoset nga shkolla.
- 3. Nëse një nxënës që diplomohet në vitin 2020, ose më tutje, nuk ka arritur nivelin e kërkuar në Provimin Keystone, a është kërkesë Vlerësimi mbi Bazën e një Projekti?**  
Asnjë nxënës nuk do të marrë pjesë në Vlerësimet mbi Bazën e Projektit, deri sa të vijnë udhëzimet nga Departamenti i Edukimit të Pensilvanisë se si do të veprohët.
- 4. Si do të vijojë më tej?**

Drejtoria Arsimore e Filadelfias edhe më tutje do të vazhdojë komunikimin me Departamentin e Edukimit të Pensilvanisë dhe zyrtarët e Shtetit për monitorimin e zhvillimeve të rregulloreve të Kapitullit 4 (Chapter 4), të cilat trajtojnë kërkesat për diplomim. Në rast se do të ketë ndryshim në ligjin aktual, informacioni do të ndahet menjëherë me prindërit/kujdestarët.